

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) me qëllim të zgjedhjes së kompanisë për blerjen e pajisjeve për procesim të kartëmonedhave, shpall këtë:

FTESË PËR PARAQITJE TE OFERTAVE PËR MAKINERITË PËR PROCESIMIN E KARTËMONEDHAVE

Kreditimi Rural i Kosovës - KRK fton kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për furnizim me makineri për procesimin (kontrollin e vërtetësisë, autenticitetit dhe përshtatshmërisë) së kartëmonedhave dhe monedhave sipas Rregullores për Operacionet me Para të Gatshme, miratuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

I. Sasia dhe lloji i makinerisë së kërkuar:

-Makineritë për procesimin e kartëmonedhave - **3 copë.**

II. Kërkesat Minimale për Makineritë për Trajtimin e Kartëmonedhave Euro bazuar në rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës lidhur me :

- Makineritë e procesimit që do të përdoren nga ana e institucionit mikro financiar (KRK) për vërtetimin dhe klasifikimin e kartëmonedhave euro, si dhe valutave të tjera.
- Duhet të jenë në gjendje të identifikojnë me saktësi kartëmonedhat të falsifikuara nga ato të vërteta.
- Makineritë për procesimin e kartëmonedhave euro duhet të jenë të listuara në listën e Bankës Qendrore Evropiane të makinerive të testuara për autentifikimin e kartëmonedhave euro
- Makinat e trajtimit të kartëmonedhave duhet të përpunojnë kartëmonedhat euro, duke klasifikuar dhe veçuar fizikisht ato pa ndërhyrjen e operatorit të makinerisë.
- Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave euro duhet të kenë numrin e kërkuar të rafteve (stackers) të dedikuara për të siguruar klasifikimin dhe veçimin e saktë të kartëmonedhave euro që procedohen.
- Makineritë e trajtimit të kartëmonedhave euro duhet të jenë të adoptueshme për të siguruar detektimin me saktësi të kartëmonedhave false të reja).
- Oferuesi duhet të sigurojë një deklaratë nga prodhuesi i makinerisë ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, që garanton se karakteristikat e makinerisë së instaluar korrespondojnë me ato të makinerisë, të përfshirë në listën e publikuar të Bankës Qendrore Evropiane dhe/ose Komisionit Evropian dhe që makineria e instaluar përpunon kartëmonedhat dhe monedhat në të njëjtën mënyrë si makineria e të njëjtit lloj të testuar nga Banka Qendrore Evropiane.

Makineritë “Banknote Processing Machines” (BPM) – Makineri të procesimit të kartëmonedhave euro, duhet të ketë së paku dy xhepa apo karakteristikat si në vijim:

- të paktën një raft i dedikuar për dalje (output stacker) për kartëmonedhat e përshtatshme për riqarkullim - Kartëmonedha të identifikuar si të vërteta dhe në gjendje të mirë kualitative.
- të paktën një raft i dedikuar për dalje (output stacker) për kartëmonedhat e papërshtatshme për riqarkullim - Kartëmonedha të identifikuar si të vërteta por në gjendje jo të përshtatshme.
- të paktën një raft i dedikuar për refuzim (reject stacker) të kartëmonedhave të dyshimta - Objekte që nuk njihen si kartëmonedha euro; Kartëmonedha euro të dyshuara si të falsifikuara; Kartëmonedha euro që nuk janë vërtetuar qartësisht.

Për më shumë shih rregulloren e BQK-së për Operacionet me Para të Gatshme.

Zgjedhja e ofertës me të volitshme do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertës më të volitshme duke u bazuar në:

-Kualiteti/çmimi i ofruar.

-Kushtet, afatgjatësia e garancionit dhe servisimit.

-Afati i liferimit.

Çmimet duhet të jenë me TVSH të përfshirë.

Afati i paraqitjes së ofertave deri më 13.09.2021

Ofertat mund të dërgohen në adresën : krk_imf@krk-ks.com apo direkt në zyrën e KRK, Rruga Behije

Dashi Nr.20 (afër stacionit të policisë nr. 2), Prishtinë.